



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

P. nr. 438/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, me Gjyqtaren Ilirjana Hoti dhe me sekretarja juridike Flutur Nagavci, në lëndën penale kundër të akuzuarës J.I. nga Gj.për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik neni 378/6-1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore Departamenti-Përgjithshëm në Gjakovë, PP/II.nr.108/18 i dt. 22.06.2018, duke vendosur në lidhje me propozimin e PTHDP-Gjakovë, për dhënien e urdhrit ndëshkimor, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me dt.**03.09.2018**, murr këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PTH-DP ne Gjakovë PP/II.nr.108/18 e dt.22.06.2018 dhe kjo Gjykatë, jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

E akuzuara:

J. I., nga Gj., Rr”K.i M. “ nr.133 , e bija e I. dhe e neves N. e gjinisë M., data e lindjes ..., ka të kryer shkollim universitar, e gjendjes së mesme ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, me ID. .

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse :

-Me dt.17.12.2017, rreth orës 23:15 min, në rrugën P. –.-COM “, rrezikon trafikun publik duke shkelur nenin 65 lidhur me nenin 255 te Ligjit mbi rregullat e trafikut rrugor nr. 05/L-088 dhe vene ne rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë , nga pakujdesia edhe pse ka qene e vetëdijshme se me një veprim te tillë do të vije deri te pasoja e ndaluar , lehtas ka marr se gjerë te ajo nuk do te vjen apo ne momentin e duhur do t’i shmanget dhe pasoja është shkaktuar ,ne atë mënyrë qe duke drejtuar automjetin e markës “T.A. djathtë ne atë te majtë ne rrugën kryesore ,ku si pasojë me pjesën anësore te krahut djathtë te automjetit e godet në pjesën anësore te krahut te djathtë automjetin e markës “...” ,me tar. regj 01-301-HK... P. , me ç ‘rast përpos dëmeve materiale ne automjete , lëndime te lehta trupore pësojnë i dëmtuari M. P. dhe bashkudhëtarët e tij T.P. dhe D.N. ,si dhe vete e pandehura J. I. ,lëndime te konstatuara dhe te përshkuara hollësisht ne ekspertizën mjeko ligjore te Dr. B. C. i dt. 07.02.2018.

-me çka ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6/1 të KPRK-së.

Andaj ,Gjykata konform nenit 4,41,43, 46,73dhe nenit 378 par.6-1 te KPRK-së ,si dhe nenit 495 te KPPK-se ,të akuzuarës J. I., e

G J Y K O N

Dënimin me gjobë në shumë prej **250 € (dyqind e pesëdhjetë euro)**, të cilën shumë është e obliguar që ta paguaj në afat prej **15 ditësh** pas plotfuqishmërisë , së këtij Aktgjykimi -Urdhër ndëshkimor, në kërcënim të përmbarimit me dhunë .

Nëse, dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim dhe në forma të tjera të parapara sipas nenit 46 të KPRK-së, atëherë i njëjti dënim në bazë të nenit 46 par.4 të KPPK-së , i zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej **12 (dymbëdhjetë) ditësh**, duke llogaritur për çdo ditë burgu nga **20,00 € (njëzet) euro**.

Të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

Detyrohet e akuzuara që ti paguaj shpenzimet procedurale shumen prej **101.10 €** (në emër të ekspertizës së komunikacionit 51.10 euro dhe 50.00 euro në emër të ekspertizës mjeko-ligjore)si dhe në emër te paushallit gjyqësor te paguaj shumen prej **30,00 €** , në afat prej **15 ditëve** ,pasi Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë .

A r s y e t i m

Pranë kësaj Gjykate Prokuroria Themelore- Departamenti i Përgjithshëm në Gjakovë, ka ngrit Aktakuzën PP/II.nr.108/18e dt.22.06.2018 , ndaj të akuzuarës J. I. nga Gj., për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6/1 te KPRK-së .

Komfor nenit 493 te KPPK-së , Propozoj Qe ndaj te akuzuarës J.I. të nxirret Urdhër Ndëshkimor me të cilin të njëjtit do t i shqiptohet dënimi me gjobë.

Para se të vazhdohet me arsyetim të Aktgjykimit për palët e pa udhëzuara është e nevojshme që t'i referohet dispozitës se nenit 378 par. 6/1 te KPRK-së e cila dispozitë për kryesit e kësaj vepre penale parasheh dënim me gjobë apo me burgim gjerë ne 3(tre) vjet .

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes komfor nenit 495 te KPPK-se, gjeti se janë plotësuar kushtet nga dispozita e nenit 493 të KPPK-se dhe pa mbajtur shqyrtimin gjyqësor, vendosi që të pranoi kërkesën e PTH - DP në Gj., për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe të shqiptoj ndaj të akuzuarit dënim me gjobë si në dispozitiv të Aktgjykimit .

Gjykata vlerëson se provat që i janë bashkangjitur propozimit për dhënien e urdhrin ndëshkimor të cilat gjinden në shkresat e lëndës siç janë:

- Kallëzimi penal me nr. Er -.... i dt.17.12.2017,
- Raporti i hetuesit mbi vend shikim e vendit te ngjarjes, Er -.... i dt.17.12.2017
- Skica nga vendi i ngjarjes të dt. 17.12.2017,
- Deklarata e të pandehurës Je. I.dhënë në St.Policor me dt.18.12.2017,
- Deklarata e të dëmtuarit M. Pr. dhënë në St.Policor me dt.18.12.2017,
- Raporti mjekësor te spitalit "I.G." në Gj.për te dëmtuarit me nr.,dt. 18.12.20178
- Ekspertizë e ekspertit të komunikacionit Mr.Sc. A. H. të dt. 15.02.2018
- Akt -Ekspertizë mjeko –ligjor Dr . B. C. të dt.29.01.2018,

-Foto dokumentacioni dhe shkresat e tjera në lëndë.

Gjykata këtë dënim e ka shqiptuar me bindje se me të njëjtin do të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë në nenin 41 të KPRK-së në mënyrë që të parandaloi kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të përmbaj personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marr bazuar në nenin 463/2 të KPP-ës.

Vendimi mbi shpenzimet procedurës penale, është bazuar në dispozitat e nenit 450 par.1 dhe 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së..

Me sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi mbi urdhrin ndëshkimor.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
P.nr.438/18 të dt.03.09.2018

Sekretare juridike
Flutur Nagavci

Hoti

Gjyqtarja
Ilirjana

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është i lejuar kundërshtimi në afat prej **8 ditësh**, nga dita e marrjes së të njëjtës ,Gjyqtares të kësaj Gjykate. Nëse e pandehuri nuk ushtron kundërshtim, Aktgjykimi do të merr formë të prerë.